



## **Mesazh I Kombeve të Bashkuara me rastin e Ditës së OKB, 24 tetor 2023**

Gjatë periudhës kur rendi ndërkombëtar po kërcënohet seriozisht dhe kur rregullimi i botës sipas parimeve juridike dhe sipas shpirtit tolerant po kundërshtohet ashpër. Organizata Botërore e Esperantos, që përbashkon folësit e esperantos nga të gjitha kombësitë dhe kulturat si dhe bindjet politike, përshëndet Kombet e Bashkuara në Ditën e OKB 2023.

Kur u krijuan Kombet e Bashkuara në vitin 1945, themeluesit e saj synonin të largonin nga bota kamxhikun e luftërave. Ndonëse ky qëllim mbetet ende i paarritur, dhe ndonëse mostoleranca, rivalitetet etnike dhe shfrytëzimi ekonomik kërcënon më tej mirëqënien botërore dhe në mënyra të ndryshme pengon bashkëpunimin shumëanësh, Kombet e Bashkuara mbeten një fanar shprese.

Shpresa ka qenë ajo që e frymëzoi Ludovik Zamenhovich të krijojë esperanton në vitin 1887 dhe të përfytyrojë një botë tjetër të tolerancës etnike dhe racore. Që nga ajo ditë, Esperanto formoi një bashkësi mbarëbotërore që synon ta bëjë botën një vend më të mirë. Ne pranojmë faktin që kapërcimi i ndryshimeve gjuhësore dhe pranimit i ndryshimësisë kulturore dhe gjuhësore përbën vetën njërin element në përparimin e paqes, por një element i rëndësishëm. Ne premtojmë mbështetjen tonë për çfarëdo përpjekje të sinqertë për ta shpënë para paqen, dhe veçanërisht përpjekjet e Kombeve të Bashkuara, një organizëm që ka punuar shumë për të penguar luftërat në epokën tonë, për të shpënë përpara bashkëpunimin shumëanësh dhe për të na kujtuar përgjegjësinë tonë të përbashkët si njerëz për të ardhmen e planetit tonë.

Në një periudhë kur bota përballet me rreziqet e kërcënimeve ndaj ekzistencës, Kombet e Bashkuara janë ende më të rëndësishme se më parë. Ne u japim me dëshirë mbështetjen tonë dhe nxisim gjithë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.